



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.19

23 shkurt

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.51, datë 7.2.2007

Për miratimin e modeleve të vendimeve, që lëshohen nga
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat
rajonale të saj, për njohjen, kthimin apo kompensimin e
pronës . 327

VENDIM
Nr.51, datë 7.2.2007

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË VENDIMEVE, QË LËSHOHEN NGA AGJENCIA E
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE DHE ZYRAT RAJONALE TË SAJ, PËR
NJOHJEN, KTHIMIN APO KOMPENSIMIN E PRONËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modeleve të vendimeve, që lëshohen nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat rajonale të saj, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Drejtësisë
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Adresa:

Tel.

Nr. _____ Prot.

Datë, ____/____/____

VENDIM

Nr. _____, datë, ____/____/____

PËR KOMPENSIM TË PRONËS

Sot më datë _____, në mbështetje të pikës 1 të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së mora në shqyrtim kërkesën nr. _____ prot, datë _____, që i përket subjektit të shpronësuar,

Kërkues: _____
(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar kërkues, si dhe adresa e deklaruar. Në rastin e trashëgimtarëve përcaktoni numrin dhe datën e dëshmisë së trashëgimisë.)

Me objekt: _____
(Objekti i kërkesës së subjektit të shpronësuar, si dhe baza ligjore e saj.)

Pasi shqyrtova kërkesën e subjektit të shpronësuar, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr. prot., datë apo ato të krijuara nga korrespondenca me institucionet e tjera, dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale _____
(si p.sh. këqyrje, matje, konfirmime etj.)

në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar,

VËREJ SE:

I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA

(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron, lidhjen gjinore që ka me subjektin e shpronësuar etj.)

II. LIGJI I APLIKUESHËM

(Citoni në mënyrë taksative dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore ku do të mbështeteni për të dhënë vendimin duke shkruar të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.)

III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

(Paraqisni të gjitha argumentet dhe arsyetimin tuaj në lidhje me mbështetjen ose jo në ligjin e aplikueshëm të fakteve të parashtruara në kërkesën e subjektit të shpronësuar.)

IV. KONKLUZIONI

(Paraqisni një konkluzion të shkurtër, nëse e pranoni ose jo kërkesën, në mënyrë të plotë ose të pjesshëm, pas analizës ligjore të fakteve që keni bërë.)

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të nenit _____ (të përmendur te ligji i aplikueshëm) të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së,

VENDOSA:

1. Të kompensoj fizikisht/financiarisht për pronën e njohur sipas vendimit nr. _____, datë _____ të Zyrës Rajonale të AKKP-së të Qarkut _____
(numri dhe data e vendimit të Zyrës Rajonale të AKKP-së të Qarkut me të cilin është njohur e drejta e pronësisë dhe kompensimit të subjektit të shpronësuar kërkuar)

subjektin e shpronësuar _____

(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar. Në rastin e trashëgimitarit/ëve ligjorë të tij të përmendet edhe numri e data e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe pjesët takuese të gjithsecilit të renditura sipas dëshmisë së trashëgimisë.)

me _____

(lloj i pasurisë si p.sh. tokë bujqësore, pyjore, truall, ndërtesë etj. sipërfaqja, përshkrimi i saj sipas informacionit të azhurnuar dhënë nga institucionet, verifikimi i saj në terren i demonstruar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur nga topografët – grupi i punës etj.)

dhe/ose me _____

(shuma në lekë).

2. Këtij vendimi i bashkëlidhet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse.

3. Vendimi hartohet në 5 kopje.

(2 kopje qëndrojnë në protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjëherë kërkuarit nga zyra e protokollit, 1 kopje dërgohet në ZRPP, si dhe 1 kopje në Avokaturën e Shtetit.)

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë ____/____/_____.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

(Emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim: Ky vendim përbën titull ekzekutiv nga data ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së,

(emër, mbiemër, firmë, vulë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Drejtësisë
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Adresa:

Tel.

Nr. _____ Prot.

Datë, ____/____/____

VENDIM

Nr. _____, datë, ____/____/____

**PËR NJOHJEN E TË DREJTËS SË PRONËSISË, KTHIMIN DHE/OSE KOMPENSIMIN
E PRONËS**

Sot më datë _____, në mbështetje të pikës 1 të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së mora në shqyrtim kërkesën nr. _____ prot, datë _____, që i përket subjektit të shpronësuar,

Kërkesues/ankues: _____
(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar kërkesues/ankues, si dhe adresa e deklaruar. Në rastin e trashëgimtarëve përcaktoni numrin dhe datën e dëshmisë së trashëgimisë.)

Me objekt: _____
(Objekti i kërkesës/ankimit të subjektit të shpronësuar, si dhe baza ligjore e saj.)

Pasi shqyrtova kërkesën/ankesën e subjektit të shpronësuar, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr. prot., datë apo ato të krijuara nga korrespondenca me institucionet e tjera, dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale _____

(si p.sh. këqyrje, matje konfirmime etj.)

në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar,

VËREJ SE:

I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA

(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron, lidhjen gjinore që ka me subjektin e shpronësuar etj.).

II. LIGJI I APLIKUESHËM

(Citoni në mënyrë taksative dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore ku do të mbështeteni për të dhënë vendimin duke shkruar të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.)

III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

(Paraqisni të gjitha argumentet dhe arsyetimin tuaj në lidhje me mbështetjen ose jo në ligjin e aplikueshëm të fakteve të parashtruara në kërkesën/ankesën e subjektit të shpronësuar.)

IV. KONKLUZIONI

(Paraqisni një konkluzion të shkurtër nëse e pranoni ose jo kërkesën/ankesën, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, pas analizës ligjore të fakteve që keni bërë.)

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të nenit _____ (të përmendur te ligji i aplikueshëm) të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së,

VENDOSA:

(një nga rastet e mëposhtme)

1. Lënien në fuqi të vendimit nr._____, datë ____/____/____ të Zyrës Rajonale të Qarkut _____.

2. Shfuqizimin e vendimit nr._____, datë ____/____/____ të Zyrës Rajonale të Qarkut _____ dhe zgjidhjen në themel si më poshtë:

a) Të njoh të drejtën e pronësisë për pronën _____

(përshkrim i plotë dhe i saktë i pronës, sipas dokumentacionit ligjor),

subjektit të shpronësuar _____

(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar. Në rastin e trashëgimitarit/ëve ligjor të tij të përmendet edhe numri e data e dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesët takuese të gjithsecilit të renditura, sipas dëshmisë së trashëgimisë),

a.1) Kthimin e pronës _____

(sipërfaqja/ kufizimet dhe përshkrimi i saj sipas informacionit të azhurnuar dhënë nga institucionet, verifikimi i saj në terren i demonstruar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur nga topografët – grupi i punës).

a.2) Të kompensojë fizikisht/financiarisht për pronën e njohur sipas shkronjës a) me _____

(lloji i pasurisë si psh. tokë bujqësore, pyjore, truall, ndërtesë etj., sipërfaqja, përshkrimi i saj sipas informacionit të azhurnuar dhënë nga institucionet verifikimi i saj në terren i demonstruar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur nga topografët – grupi i punës etj.)

dhe/ose _____

me _____

(shuma në lekë)

a.3) Të njohë të drejtën e parablerjes në bazë të nenit _____ të ligjit nr.9253, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, për pronën _____

(përshkrim i plotë dhe i saktë i pronës sipas dokumentacionit ligjor).

3. Kthimin për rishqyrtim në Zyrën Rajonale të AKKP-së të Qarkut _____.

4. Këtij vendimi i bashkëlidhet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse.

5. Vendimi hartohet në 5 kopje.

(2 kopje qëndrojnë në protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjëherë kërkuesit nga zyra e protokollit, 1 kopje dërgohet në ZRPP, si dhe 1 kopje në Avokaturën e Shtetit.)

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor _____, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë ____/____/_____.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

(Emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim: Ky vendim përbën titull ekzekutiv nga data ____/____/____
Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, _____
(emër, mbiemër, firmë, vulë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Drejtësisë
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave
Zyra Rajonale e Qarkut _____

Adresa:

Tel.

Nr. _____ Prot.

Datë, ____/____/____

VENDIM

Nr. _____, datë, _____

PËR NJOHJEN E TË DREJTËS SË PRONËSISË, KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS

Sot më datë _____, në mbështetje të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Zyrës Rajonale të Qarkut _____, mora në shqyrtim kërkesën nr. _____ prot, datë _____, që i përket subjektit të shpronësuar.

Kërkues:

(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar kërkues, si dhe adresa e deklaruar. Në rastin e trashëgimtarëve përcaktoni numrin dhe datën e dëshmisë së trashëgimisë.)

Me objekt:

(Objekti i kërkesës së subjektit të shpronësuar, si dhe baza ligjore e saj.)

Pasi shqyrtova kërkesën e subjektit të shpronësuar, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr. prot., datë, ato të krijuara nga korrespondenca me institucionet e tjera, dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale _____

(si këqyrje, matje, konfirmime etj.)

në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar,

VËREJ SE:

I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA

(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron, fakti nëse i është drejtuar ose jo më parë komisionit, lidhjen gjinore që ka me subjektin e shpronësuar etj.)

II. LIGJI I APLIKUESHËM

(Citoni në mënyrë taksative dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore ku do të mbështeteni për të dhënë vendimin duke shkruar të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.)

III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

(Paraqisni të gjitha argumentet dhe arsyetimin tuaj në lidhje me mbështetjen ose jo në ligjin e aplikueshëm të fakteve të parashtruara në kërkesën e subjektit të shpronësuar.)

IV. KONKLUZIONI

(Paraqisni një konkluzion të shkurtër nëse e pranoni ose jo kërkesën, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, pas analizës ligjore të fakteve që keni bërë.)

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit _____ (të përmendur te ligji i aplikueshëm) të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Zyrës Rajonale të AKKP-së të Qarkut _____,

VENDOSA:

(një nga rastet e mëposhtme)

a) Të njoh të drejtën e pronësisë për pronën _____

(përshkrim i plotë dhe i saktë i pronës sipas dokumentacionit ligjor),
subjektit të shpronësuar _____

(Gjeneralitetet e subjektit të shpronësuar. Në rastin e trashëgimitarëve ligjor të tij të përmendet edhe numri e data e dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesët takuese të gjithsecilit të renditura sipas dëshmisë së trashëgimisë),

a.1) Kthimin e pronës _____

(sipërfaqja/kufizimet dhe përshkrimi i saj sipas informacionit të azhurnuar dhënë nga institucionet, verifikimi i saj në terren i demonstruar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur nga topografët – grupi i punës.)

a.2) Të njohë të drejtën e kompensimit për pronën _____

(përshkrimi i plotë dhe i saktë i pronës të njohur në shkronjën a)

a.3) Të njohë të drejtën e parablerjes në bazë të nenit _____ të ligjit nr.9253, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, për pronën _____

(përshkrim i plotë dhe i saktë i pronës sipas dokumentacionit ligjor),

b) Këtij vendimi i bashkëlidhet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse.

c) Vendimi hartohet në (6) kopje.

(2 kopje qëndrojnë në protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjëherë kërkuesit nga zyra e protokollit, 1 kopje dërgohet në Zyrën Qendrore të AKKP-së, 1 kopje dërgohet në ZRPP, si dhe 1 kopje pranë Avokaturës së Shtetit.)

ç) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të tij pranë Zyrës Qendrore të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Tiranë.

U shpall sot më datë ____/____/____.

**Drejtori i Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave
Qarku _____**

(Emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim: Ky vendim përbën titull ekzekutiv nga data ____/____/____ Drejtori i Zyrës Rajonale të AKKP-së, të Qarkut _____ (emër, mbiemër, firmë, vulë)
--

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 23.2.2007
Doli nga shtypi më 23.2.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë